

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – koleji i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani, kryetare, Erdogan Haxhibeqiri dhe Beshir Islami, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit F. K., nga ..., të cilin e përfaqëson me autorizim F. S., nga ..., juriste e diplomuar, kundër të paditurës komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, KK Gjilan, për anulimin e konkursit, lidhur me përzgjedhjen e kandidatit, duke vendosur me revizionin e të paditurës si dhe kandidatit të përzgjedhur G. P., parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr. 913/2016, datë 10.09.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 06.02.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET si i pabazuar revizioni i të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit KK Gjilan, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr. 913/2016 datë 10.09.2019.

II.HEDHET si i palejuar revizioni i Gëzim Pira nga Gjilani (kandidat i përzgjedhur), parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr. 913/2016 datë 10.09.2019.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Ac.nr. 913/2016 datë 10.09.2019, refuzohet e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria e Arsimit dhe vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr. 563/2015 datë 21.12.2015, me të cilin në pjesën I të dispozitivit, aprovohet kërkesëpadia e paditësit F. K. nga ., e ushtruar ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e

Arsimit KK Gjilan, dhe anulohet konkursi publik ..., i datës 21.07.2015, i shpallur nga ana e të paditurës, me të cilin është kërkuar plotësimi i vendit të lirë të punës mësimdhënës për ..., me plotësim norme orkestër në Gjilan, në Shkollën e Mesme të Lartë përkatësisht Shkollën e Muzikës në Gjilan dhe me pjesën II të dispozitivit obligohet e paditura që në afat prej 15 ditësh të rishpall konkursin për vendin e punës mësimdhënës për Solfezh, me plotësim norme Orkestër në Gjilan, në Shkollën e Mesme të Lartë përkatësisht Shkollën e Muzikës, në Gjilan. Me pjesën III të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i bart shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Kundër këtij aktgjykimi revizion ka parashtruar e paditura për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që aktgjykimet e të dy gjykatave të ndryshohen dhe të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësve apo të prishen dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë revizion ka paraqitur edhe kandidati i përzgjedhur Gëzim Pira përmes të autorizuarit të tij av. V. H., nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe shkeljes së drejtës të paraparë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Me propozim që revizioni të pranohet si i bazuar dhe të prishen aktgjykimet e të dy gjykatave dhe lëndën të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimeve të goditur në bazë të nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar ndërsa revizioni i kandidatit të përzgjedhur Gëzim Pira është i palejuar.

Nga shkresat e lëndës del se Drejtoria Komunale e Arsimit në bazë të nenit 5 pika (c) e Ligjit për Arsim para Universitar në Republikën e Kosovës dhe nenit 35 të Ligjit të Punës, ka shpallur konkurs për plotësimin e vendit të lirë të punës, në mes tyre edhe për pozitën e mësimdhënësit në Solfezh, më datë 21.07.2015, me plotësim norme Orkestër në Gjilan, në Shkollën e Mesme të Lartë përkatësisht Shkollën e Muzikës në Gjilan, të cilat pozita ishin për kohë të caktuar deri më datën 31.08.2016. Pas skadimit të këtyre kontratave për këto vende të

punës Drejtoria Komunale e Arsimit në cilësi të mësimdhënësit do të bënte një analizë të tepricave të mësimdhënësve që mund të ketë për vitin shkollor për vitin 2016/2017, dhe në rast se nuk paraqiten tepricat e mësimdhënësve, punëtorëve të pranuar do t'u vazhdohet kontrata, duke potencuar se mësimdhënësit të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune në arsimin gjilanas, të cilët konkurrojnë për këto vende pune, aplikacionet e tyre nuk do të shqyrtohen dhe nuk do të thirren në intervistë. Po ashtu, në kushtet e konkursit kishte përcaktuar se për kualifikimin për mësimdhënës kërkohet përgatitja profesionale sipas normativave të MASHT-it në fuqi.

Me Udhëzimin Administrativ të (MASHT), nr. 05/2015 për mësimdhënësit e arsimit profesional ,për lëndën e Solfezh-it, duhet të ketë përgatitjen profesionale, sipas nenit 19,paragrafi 1.2 nën paragrafi 1.2 Master i muzikës (në kompozim, teori)studimet e kompletuara, pika 1.2.2 Master i Muzikës (pedagogji e përgjithshme muzikore-punimi i masterit nga lënda e Solfezhit).

Nga dokumentacioni për përgatitjen profesionale të kandidatëve vërtetohet se paditësi F. K. posedon diplomën Universitare Fakultetin e Arteve, me gradë Master i Teorisë së Muzikës dhe ka mbrojtur me sukses temën e masterit''zbatimi i planit mësimor të lëndës harmoni në shkollat e mesme të Kosovës'', ndërsa kundër kandidati i tij G. P., posedon diplomën Universitare Fakulteti i Arteve me gradën Master i Pedagogjisë së Muzikës dhe e ka mbrojtur me sukses temën e masterit ''Aplikimi i muzikës te fëmijët e moshës parashkollore''. Komisioni për intervistim dhe vlerësimin e kandidatëve F. K., është vlerësuar me gjithsejtë 60 pika, ndërsa G. P.. me gjithsej 61.5 pika.

Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan duke vepruar sipas rekomandimit të Komisionit intervistues me Vendimin nr. ..., me datë 28.08.2015, në vendin e punës Solfezh me plotësim norme orkestër ka përzgjedhur kandidatin G. P. Kundër këtij vendimi paditësi ka paraqitur ankesë me nr. ... të datës 01.09.2015. Komisioni për shqyrtimin e ankesave me vendimin ..., të datës 22.09.2015, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit dhe ka lënë ë fuqi vendimin e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjilan, nr. ..., të datës 28.08.201.

Gjykata e shkallës së parë duke u nisur nga gjendja e këtillë e çështjes ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit , pasi që ka vërtetuar se procedura e intervistimit dhe vlerësimit profesional gjatë pranimit të kandidatëve

është zhvilluar në kundërshtim me nenin 19 pika 1.2 të Udhëzimit Administrativ të (MASHT),nr. 05/2015 për mësimdhënësit e arsimit profesional dhe e obligoj të paditurën që të rishpall konkurs tjetër publik për vendin e lirë të punës mësimdhënës për Solfezh, me plotësim norme Orkestër në Gjiilan , në Shkollën e Mesme të Lartë përkatësisht në Shkollën e Muzikës në Gjiilan. Në shpalljen e konkursit të ketë parasysh nenin 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, që ndalon çdo lloje diskriminimi si dhe nenin 8 paragrafi 2 dhe nenin 5 paragrafi 1 të Ligjit të Punës së Kosovës, Udhëzimin Administrativ të (MASHT), nr. 05/, si dhe të hiqen kufizimet për aplikime në konkursin e publikuar për kandidatët që janë në marrëdhënie të rregullt pune.

Gjykata e Apelit në procedurë të ankimimit e pranon si të drejtë vlerësimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimin jo të plot dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimin e gabuar të së drejtës material, andaj ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se gjykatat e instancës më të ulët drejtë kanë zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë nuk përmbajnë shkelje thelbësore të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare. Gjykatat e instancës më të ulët, në aktgjykimet e tyre kanë dhënë arsye të mjaftuara për faktet vendimtare për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Kështu që pretendimet në revizion nuk e vejnë në pyetje ligjshmërinë e aktgjykimin të goditur.

Gjykata Supreme e Kosovës e pranon si të drejtë vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë se e paditura, me rastin e përzgjedhjes së kandidatit G. P., në lëndën Solfezh ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 19 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2015, për normativën për mësimdhënësit e arsimit profesional, i cili ka qenë në fuqi në kohën e publikimit të konkursit, pasi i njëjti nuk i ka plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë dispozitë, pavarësisht faktit se ka master në pedagogji për të ligjëruar lëndën e Solfezh-it, duhet të ketë punimin e masterit në

lëndën e solfezh-it, ndërsa kandidati i përzgjedhur e ka të mbrojtur temën “Aplikimi i muzikës te fëmijët e moshës parashkollore”, për dallim nga paditësi F. K., i cili ka përgatitje profesionale Master i teorisë së muzikës , dhe për të ligjëruar lëndën e Solfezhit, sipas par.1.2.1, të Urdhëresës të sipërcituar i plotëson kriteret e përcaktuara, pasi që për paditësin F. K., nuk është kërkuar tema adekuate nga studimet master, kurse për kundër kandidatin është kërkuar. Prandaj, kjo Gjykatë e pranon si të drejtë përfundimin e të dy gjykatave se kandidati i përzgjedhur nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr.05/2015.

Kjo Gjykatë po ashtu vlerëson se kushtet e konkursit ,ku kufizohet e drejta për të konkurruar në këto vende të punës mësimdhënësve të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune, është në kundërshtim me nenin 8 paragrafi 2 dhe nenin 5 paragrafi 1 të Ligjit të Punës së Kosovës, kështu që gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale kur ka anuluar konkursin e publikuar ..., të datës 21.07.2015, kjo për faktin se, kufizimi i këtillë për aplikimin e kandidatëve në konkursin e publikuar është diskriminues dhe ven në pozitë të pa barabartë kandidatët, e sidomos kur ti shtohet fakti se edhe kandidati i përzgjedhur për kundër përkufizimit të tillë është ftuar në intervist dhe është përzgjedhur edhe pse ka qenë në marrëdhënie pune.

Nuk qëndrojnë parashtrimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedues kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 lidhur me nenin 2 ,paragrafi 4 të LPK, me arsyetim se paditësi nuk ka interes për padinë e parashtruar dhe anulimin e konkursit pasi që i njëjti është në marrëdhënie pune tek e paditura me normë të plotë 20 orë pune. Parashtrimet e këtilla nga kjo gjykatë u vlerësuan si të paqëndrueshme dhe si të tilla u refuzuan për arsye se edhe kundër kandidati i pranuar ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kjo nuk ka qenë pengesë ligjore që e paditura kandidatin në fjalë ta përzgjedhë.

Po ashtu nuk qëndrojnë pretendimet në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika (n) e LPK, për arsye se në revizion e paditura ,nuk jep shpjegime se cila pjesë e aktgjykimit ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet , cila pjesë e dispozitivit është i pa kuptueshëm dhe kontradiktor me vetveten dhe me arsyetimin, për të cilat fakte vendimtare nuk janë treguar arsyet cilat fakte janë të paqarta dhe kontradiktore. Ndërsa Gjykatë

e revizionit në bazë të nenit 215 të LPK-së, e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e gabuar të së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore .

Gjykata Supreme e Kosovës, e ka hedh poshtë revizionin e paraqitur nga kandidati i përzgjedhur G. P., për arsye se i njëjti nuk është palë në procedurë në këtë kontest, e as si palë e interesuar nuk është përfshirë në këtë procedurë. Prandaj kjo Gjykatë në kufi të autorizimeve të përcaktuara me nenin 221 të LPK-së, ka vendosë si në pjesën II të dispozitiv të aktgjykimit.

Nga sa u tha më sipër me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr. 4/2020, më 06.02.2020

Kryetare e kolegjit,
Gyltene Sylejmani